

VENDIM
Nr.609, datë 21.12.1999

PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE BANESASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1999, të përdoren 100 milionë lekë për blerjen në tregun e lirë, për familjet e pastreha, të përndjekura politike.

2.Përdorimi i fondeve të mësipërme të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vet qytetarëve, mbështetur në listat nominale dhe strukturat e apartamenteve tip që përfitojnë, të hartuar nga Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë.

3.Enti Kombëtar i Bnesave, bazuar në listat nominale, kryen veprimet financiare me pronarët shitës të banesave, vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumentacionit ligjor përkatës, që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga qytetarët, që e përfitojnë atë sipas këtij vendimi.

4.Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave të shoqëruara me strukturat përkatëse, i vë në dispozicion secilit qytetar masat limit të përfitimit falas.

a)Për apartamentet 1+1 shumën prej 1.63 milionë lekësh.

b)Për apartamentet 2+1 shumën prej 2.04 milionë lekësh.

c)Për apartamentet 3+1 shumën prej 2.37 milionë lekësh.

d)Këto shuma limit, të cilat do të indeksohen me vlerën e koeficientit “k”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.214, datë 28.4.1999, “Për miratimin e e kosos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, të përballohen nga buxheti i shtetit.

5.Kur shuma e vënë në dispozicion të qytetarit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, e indeksuar dhe me koeficientin “k”, rezulton më e madhe se vlera e tregut, atëhere qytetari nuk do të përfitojë më shumë se vlera e tregut.

6.Fondi prej 100 milionë lekësh të kalojë në llogri të veçantë në Bankën e Kursimeve për t’u përdorur nga EKB-ja, për familjet e pastreha të përndjekurve politikë.

7.Qytetarët që përfitojnë sipas këtij vendimi, kur nuk kryejnë veprimet për blerjen e banesave brenda një afati 4-mujor nga momenti i vënies në dispozicion të fondeve përkatëse, u humbet e drejta e përfitimit si familjet të pastreha.

8.Ngarkohen Ministria e Financave, Enti Kombëtar dhe Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta